

URDHËR
Nr. 53, datë 14.11.2025

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË EKONOMISË DHE INOVACIONIT, Z. MARTIN KAJO**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të neneve 3, 5, 11 dhe 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të vendimit nr. 516, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, zëvendësministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, z. Martin Kajo, për ushtrimin e kompetencave në fushat e përgjegjësisë, si:

a) politikat për stimulimin e aktiviteteve inovative, për rritjen e produktivitetit ekonomik dhe institucional, përmes zhvillimit të teknologjisë dhe bashkëpunimit efikas;

b) politikat për identifikimin e koncepteve, proceseve novatore dhe teknikave të reja, përmes studimeve dhe analizave krahasuese, për hartimin e strategjive dhe zbulimin e mundësive të reja të inovacionit;

c) politikat për promovimin e inovacionit dhe teknologjisë informative në funksion të rritjes ekonomike dhe zhvillimit;

d) politikat për zhvillimin e bashkëpunimit përmes programeve të trajnimit dhe konsulencës;

e) politikat për konsolidimin e fondeve dhe mekanizmave mbështetës për shërbimet inovative dhe sektorët zhvillimorë të ekonomisë;

f) politikat për krijimin e mekanizmave institucionalë koordinues ndërmjet shkencës, sektorit privat dhe politikëbërjes;

g) politikat dhe strategjitë shtetërore për sigurimin e standardeve, cilësisë, aksesit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, për të garantuar ushtrimin e të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimin e jetesës;

h) politikat për rregullimin dhe harmonizimin e planeve dhe projekteve të digjitalizimit, në përputhje me standardet e qeverisjes elektronike dhe praktikat e Bashkimit Evropian;

i) politikat për mbrojtjen e pronësisë intelektuale;

j) politikat për krijimin dhe zhvillimin e *startup*-eve;

k) politikat për mbështetjen e veprimtarisë së punonjësve lëvizës digjitalë;

l) politikat për mbështetjen e kërkimit shkencor në funksion të zhvillimit ekonomik.

2. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të ndjekë, monitorojë, koordinojë me institucionet e varësisë, agjencitë autonome, drejtoritë në përbërje të ministrisë dhe të përgjigjet përpara ministrit, mbi:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave për stimulimin e inovacionit dhe rritjen e produktivitetit përmes teknologjisë;

b) identifikimin dhe zbatimin e koncepteve dhe proceseve novatore, si dhe zhvillimin e analizave krahasuese për politikën ekonomike dhe shoqërore;

c) promovimin e inovacionit dhe teknologjisë informative si instrument për rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimit;

d) hartimin dhe zbatimin e programeve për bashkëpunim, trajnim dhe konsulencë në fushën e inovacionit;

e) konsolidimin e fondeve për shërbime inovative dhe mbështetjen e sektorëve zhvillimorë të ekonomisë;

f) krijimin dhe funksionimin e mekanizmave institucionalë për koordinimin ndërmjet shkencës, sektorit privat dhe institucioneve publike;

g) hartimin, zhvillimin dhe monitorimin e politikave dhe strategjive për transformimin digjital dhe shërbimet publike elektronike, duke siguruar standarde të larta dhe akses të barabartë për qytetarët;

h) hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e pronësisë intelektuale;

i) zhvillimin dhe mbështetjen e ekosistemit të *startup*-eve;

j) hartimin dhe zbatimin e politikave për mbështetjen e punonjësve lëvizës digjitalë;

k) hartimin dhe zbatimin e politikave për kërkimin shkencor në funksion të zhvillimit ekonomik;

l) krijimin e programeve për tërheqjen e profesionistëve dhe transferimin e ekspertizës në ekonominë vendase;

m) forcimin e ekosistemit të *startup*-eve në nivel kombëtar dhe krijimin e kushteve të qëndrueshme për zhvillimin e sipërmarrjes në të gjitha rajonet e vendit;

n) zhvillimin e programeve për inkubatorë dhe akseleratorë të fokusuar në teknologjitë e gjelbra dhe transformimin digjital;

o) hartimin dhe zbatimin e politikave për përafrimin e ligjeve me standardet e BE-së, në fushën e patentave, markave dhe të drejtave të autorit, për të garantuar mbrojtje efektive dhe klimë të sigurt investimi.

3. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë mbikëqyrjen e performancës dhe raportimet periodike të institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI);

b) Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve (*Startup Albania*);

c) Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës (AIE).

4. Zëvendësministri, sipas kompetencave dhe detyrave funksionale të deleguara në fushat përkatëse të përgjegjësisë, është përgjegjës edhe për mbikëqyrjen, lidhur me:

a) strukturën e negociatave dhe bashkërendimin e qëndrimit negociues për secilin kapitull brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë, të *acquis*, përpara miratimit nga Këshilli i Ministrave;

b) masat e përcaktuara në Agjendën e Reformave brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë, duke siguruar koordinimin dhe harmonizimin e tyre përpara miratimit nga Këshilli i Ministrave;

c) procesin normativ, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për projektet e huaja brenda fushave të përgjegjësisë;

d) procesin e hartimit dhe ndjekjen e procedurës për miratimin në Këshillin e Ministrave dhe Kuvend të projektakteve ligjore/nënligjore në fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrisë, si dhe të proceseve në kuadër të PKIE-së.

5. Institucionet e varësisë, agjencitë autonome dhe drejtoritë në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit raportojnë detyrimisht 1 herë në muaj dhe, rast pas rasti, sipas kërkesës të zëvendësministrit për çështjet që janë specifikuar në këtë urdhër, pa cenuar pavarësinë operacionale të tyre.

6. Zëvendësministri raporton me shkrim te ministri për zbatimin e detyrave të caktuara në këtë urdhër sipas kërkesës së ministrit dhe detyrimisht 1(një) herë në javë për detyrat afatshkurtra dhe 1 (një) herë në muaj për detyrat dhe përgjegjësitë e deleguara sipas këtij urdhri dhe ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

7. Zëvendësministri, sipas parashikimeve të këtij urdhri, autorizohet të nënshkruajë:

a) akte shkresore të iniciuara në nivel zëvendësministri brenda fushave të përgjegjësisë, si dhe ato në përmbushje të marrëveshjeve të nënshkruara;

b) akte shkresore që lidhen me plotësimin e detyrimeve që rrjedhin në cilësinë e tij të anëtarit apo kryetarit të grupeve të punës;

c) çdo shkresë/akt/procedurë shkresore tjetër me autorizim të posaçëm të ministrit.

8. Çdo akt tjetër që vjen në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

9. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates ose të deleguar.

10. Ngarkohen zëvendësministri, z. Martin Kajo, institucionet e varësisë, agjencitë autonome dhe drejtoritë e aparatit në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Delina Ibrahimaj